

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Blokothen në Itali e Kroaci specat dhe açuget nga Shqipëria
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1393968.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 20:12:31 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	24 shtator 2026, 20:08:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 24 shtator 2026, 20:07:00 UTC → 24 shtator 2026, 20:09:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f170b6377e715018dfbd9f128a9181f7e821ad2552ed523a0c95e3960297e2e6
TEKSTI	c3b74a93a3ec5d2343ea494e2b0f21ea9a8a1eee534d734cefac5b0130c5a5f2
PAMJA	18fe0e231d6bc9869f393dc3cefb6d3ab35d7e9909b8b6c1e33135dbe011ebbb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	849bbea767dcdd62e0703266fbf8294e544c99632d744a45e3db0ef044bd821c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	de40688aef4c4ba129d7a84fd77d2b1b27a16260a8d1d580a5a1a060453e9f69
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/849bbea767dcdd62e0703266fbf8294e544c99632d744a45e3db0ef044bd821c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Bllokohen në Itali e Kroaci specat dhe açuget nga Shqipëria

Shkruar nga: M Gjini | Publikuar më: 24.09.2026, 22:08

Share
 Share



Problemet me sigurinë ushqimore po dëmtojnë sërish imazhin e produkteve shqiptare në tregjet europiane. Pas perimeve, tashmë alarmi u ka kaluar edhe produkteve të detit, ku autoritetet në Itali dhe Kroaci kanë bllokuar ngarkesa me origjinë nga Shqipëria për shkak të pranisë së substancave të rrezikshme për shëndetin.

Açuget me nivel alarmant histamine në Itali

Në Itali është bllokuar një sasi açugesh të eksportuara nga kompania shqiptare "Poseidoni". Gjatë kontrolleve të trupave inspektuese në supermarketet italiane, produkti ka rezultuar me prani të lartë të histaminës, një ndotës biologjik që nuk shkatërrohet as gjatë procesit të gatimit apo trajtimit termik dhe që mund të shkaktojë helmim të rëndë te njerëzit.

Analizat laboratorike treguan se niveli i histaminës ishte 800 mg/kg, duke kaluar dyfishin e limitit maksimal të lejuar prej 400 mg/kg. Pas këtij zbulimi, gjithë sasia problematike u tërhoq menjëherë nga tregu italian.

Kroacia bllokoi specat nga Elbasani për të katërtën herë brenda muajit

Nga ana tjetër, autoritetet në Kroaci kanë kapur sërish me shkelje eksportet e perimeve nga Shqipëria. Bëhet fjalë për një sasi prej 3,427 kg specat të kuq, të prodhuar në fshatin Mollas të Elbasanit, të cilët kanë rezultuar me ngarkesë të lartë të insekticidit Flonicamid.

Kjo substancë përdoret për të luftuar morrin e bimëve dhe mizën e bardhë, por analizat treguan një nivel prej 0.8 mg/kg, ndërkohë që prania e këtij preparati në produkt duhet të jetë zero (n/a). Kjo dëshmon se fermeri ka abuzuar me përdorimin e helmimit dhe nuk ka respektuar kohën e nevojshme që ilaçi të shpërbëhet para vjeljes.

Kjo është ngarkesa e katërt brenda këtij muaji që bllokohet nga Kroacia për të njëjtën arsye.

Goditje për fermerët e ndershëm

Përveç rrezikut për shëndetin e konsumatorëve, kjo situatë sjell pasoja të rënda ekonomike. Sa herë që Shqipëria përballlet me skandale të tilla të sigurisë ushqimore, çmimi i grumbullimit të prodhimit vendor pëson rënie drastike brenda 24 orëve.

Mungesa e kontrolleve rigorozë nga Ministria e Bujqësisë dhe papërgjegjshmëria e disa individëve po penalizojnë me qindra fermerë të ndershëm, të cilët detyrohen ta shesin prodhimin e tyre nën kosto.

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).



Më të Lexuarat



ARTIKULL JOETIK?

KLIKO PER TE VOTUAR

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

Puno me ne!

Marketing

Politika e privatësisë

Rreth Nesh

Kushtet e përdorimit

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.